



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Jaguar" Sh.P.K. të datës 16.10.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRAOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Jaguar" Sh.P.K. të datës 16.10.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Jaguar" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 16.10.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. – *“menaxheri i sigurimit nuk duhet të posedoj modoemos kualifikime arsimore "universitare", dhe se rolin e menaxherit mund ta kryejnë të gjithë personat fizik edhe me kualifikim arsimor "të mesëm" konform procedurave ligjore”.*

Lidhur me këtë pretendim është gjetur se kërkesa e DT sipas të cilës menaxheri duhet të ketë diplomë universitare është kërkesë bazike dhe e domosdoshme për të realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit të kontratës lidhur me këtë projekt. Në DT nuk është kufizuar fare drejtimi i studimeve universitare prandaj nga cilido këndvështrim i mundshëm kjo kërkesë nuk mund të cilësohet si diskriminuese apo favorizuese. Prandaj ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

P.2. – *“kërkesat tuaja në lidhje me posedimin e një (1) menaxheri dhe 3 punëtorëve të licensuar për mbrojtje të afërt është e pakuptimtë dhe e panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, pasi që nuk kemi asnjë pozicion tek paramasa që kërkohet sigurim i veçantë për mbrojtje të afërt e as nuk kemi ndonjë arsyetim se ku do të veprojnë këta persona/punëtor, nuk ka arsyetim se a kërkohen për Kryetarin e Komunës apo për cfarë”.*

Lidhur me këtë pretendim është gjetur se kërkesa për 3 punonjës të licensuar për mbrojtje të afërt nuk është në përputhje me paramasën dhe si e tillë nuk është e domosdoshme për të realizuar me sukses kontratën që synohet të lidhet nga ky aktivitet i prokurimit. Rrjedhimisht pretendimi është i bazuar ndërsa kërkesa si e tillë duhet të ndryshohet duke larguar pjesën e kërkesës për 3 punonjës të licensuar për mbrojtje të afërt.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij të dytë por jo edhe pretendimine tij të parë. Prandaj kërkesa e parashtruesit është miratuar vetëm si pjesërisht e bazuar. AK do të korrigjoj dosjen e tenderit në përputhje me elaborimet më sipër në këtë vendim.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.10.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Page 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net